

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË SHQIPËRI (VITI FISKAL 2004)*

HYRJE

Investimet e huaja direkte (IHD) zënë një vend të rëndësishëm në panoramën ekonomike të vendeve në zhvillim. Ato sigurojnë investime të nevojshme për rritjen ekonomike dhe zhvillimin e teknologjisë, kur kursimet e brendshme nuk mund t'i sigurojnë ato. Gjithashtu, flukset e kapitalit shërbejnë si sinjal që tregon se kushtet e ekonomisë së një vendi kanë ndryshuar, në raport me ato jashtë. Këto flukse ndikojnë mbi një sërë variablash ekonomike të një vendi, si në deficitin e llogarisë korente, në kursin e këmbimit, në kursimet dhe investimet në vend, në punësimin etj..

Shumë vende në zhvillim kanë përfituar nga flukset e kapitalit në formën e IHD-ve. Duke luftuar mungesën e kapitalit nga e cila vuanin tregjet e mbyllura, ato kanë favorizuar përdorimin efikas të këtyre burimeve, si dhe kanë krijuar një mjedis konkurrues që u ofron investitorëve rendimente gjithnjë e më të larta.

Një efekt pozitiv afatgjatë i IHD është transferimi nga vendet e origjinës në vendet pritëse të tyre, i teknologjisë së prodhimit dhe i mënyrave më efikase të organizimit industrial. Në këtë vazhde, IHD ka gjithashtu efekt pozitiv edhe mbi rendimentin e firmave vendase. Në përgjithësi, marrëdhënia shkakësore e dyanshme ndërmjet IHD dhe stabilitetit ekonomik e politik ka qenë pozitive¹, pra stabiliteti ekonomik dhe politik ka nxitur nivele më të larta të IHD. Nga ana tjetër, përqëndrimi i lartë i IHD në një vend ka ndikuar pozitivisht në stabilitetin e vendit. Një tjetër aspekt pozitiv është fakti që, megjithë tendencat e ciklikalitetit, kapitali i ardhur në formën e IHD nuk është lehtësisht i transferueshem brenda një kohe të shkurtër, pra paraqet më pak rrezikshmëri se format e tjera të kapitalit financiar për stabilitetin monetar të një vendi.

Përveç përparësisë për hartimin e një kuadri institucional për nxitjen e investimeve të huaja në Shqipëri, një domosdoshmëri e kohës është matja e saktë e IHD-ve në vend. Për këtë qëllim, Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Institutin e Statistikave organizon anketime të përvitshme pranë ndërmarrjeve me pjesëmarrje të huaj në kapitalin themeltar të tyre. Qëllimi i këtyre vrojtimeve qëndron në evidentimin e investimeve të huaja në Shqipëri, nëpërmjet anketimit në shkallë kombëtare të ndërmarrjeve me kapital të huaj dhe të përbashkët, që zhvillojnë aktivitetin e tyre në Shqipëri.

Vrojtimi që po analizojmë është i dyti në rradhën e anketimeve të ndërmarrja nga Banka e Shqipërisë. Për monitorimin e kësaj baze të dhënash, Banka e Shqipërisë ka planifikuar organizimin e anketimeve vjetore. Këto anketime do të realizohen mbi në një vëllim zgjedhjeje të nxjerrë nga popullata e ndërmarrjeve të investimit direkt në vend. Ndërkohë, anketimi gjithëpërfshirës i IHD-ve në Shqipëri do të kryhet me një frekuencë 3-vjeçare.

Për Bankën e Shqipërisë, sukseesi i kësaj nisme është i një rëndësie të veçantë, jo vetëm për përllogaritjen e saktë të fluksit të investimeve të huaja në Shqipëri, por gjithashtu për llogaritjen e stokut të këtyre investimeve, që do të shërbejë si bazë për hartimin e pozicionit ndërkombëtar të investimeve (PNI) të Shqipërisë.

Kuadri ligjor dhe ekonomia informale bëjnë që të mos kemi një statistikë të plotë dhe afër realitetit mbi investimet e huaja direkte në Shqipëri.

Krijimi i një historiku të dhënash për kapitalin e huaj në formën e investimeve direkte si dhe analizat studimore të rezultateve të vrojtimit, mundësojnë një kuadër të qartë të origjinës së kapitalit të huaj të hyrë në Shqipëri, sektorët e ekonomisë që kanë thithur më shumë kapitale të huaja, si dhe ndikimin e tyre në ekonominë vendase.

Analiza e karakteristikave të tregut të investimeve të huaja direkte në Shqipëri si dhe produktivitetit të tyre, mund të shërbejë si një faktor nxitës në hapjen e ndërmarrjeve të reja me kapital të huaj në vend.

Materiali vijon me përcaktime dhe metodologji të lidhura me konceptin e IHD-ve. Në këtë seksion përshkruhet metoda e ndjekur për vlerësimin e stokut të kapitalit të huaj. Analiza e rezultateve të vrojtimit është ndarë në dy seksione bazë. Seksioni i dytë, analizon karakteristikat numerike të ndërmarrjeve me kapital të huaj dhe të përbashkët që zhvillojnë aktivitetet në Shqipëri (të tilla si shpërndarja sektoriale e ndërmarrjeve, origjina e tyre, shpërndarja zonale e ndërmarrjeve me kapital të huaj në vend, përqëndrimi i fuqisë punëtore etj.).

Në seksionin e tretë, analizohen karakteristikat sasiore të IHD-ve, që kanë të bëjnë kryesisht me vlerësimin e stokut të kapitalit sipas vendit të origjinës dhe me shpërndarjen e tij sipas sektorëve të ekonomisë.

1. PËRCAKTIME DHE METODOLOGJI

Megjithëse përkufizimi i investimeve të huaja direkte ka pësuar ndryshime në vite, historikisht një kufi i caktuar pjesëmarrjeje me kapital dhe ideja që investitori planifikon të shfaqë influencë kontrolli në ndërmarrje, kanë qenë ngushtësisht të lidhura me kuptimin e IHD-ve. Në përpjekjet për harmonizim, FMN dhe OECD kanë zhvilluar një përkufizim të përbashkët: "...investimi i huaj direkt reflekton qëllimin e sigurimit të një interesi të qëndrueshëm nga një njësi rezidente e një ekonomie (investitor direkt) në një njësi rezidente të një tjetër ekonomie (ndërmarrje e investimit direkt)...".

Investimi i huaj direkt përfshin së bashku transaksionin fillestar për vendosjen e marrëdhënies ndërmjet investitorit dhe ndërmarrjes, dhe të gjitha transaksionet kapitale pasuese ndërmjet tyre dhe ndërmjet filialeve, pavarësisht formës ligjore në të cilën janë regjistruar – si persona juridikë apo persona fizikë.

Botimi i Pestë i Manualit të Bilancit të Pagesave të FMN-së (BPM5) përcakton si investitor direkt pronarin e 10 për qind ose më shumë të kapitalit të një ndërmarrjeje. Kjo përqindje përdoret si kufi ndarjeje ndërmjet investimit direkt dhe investimit të portofolit si pjesëmarrje në aksione. Kështu, kur një jorezident, i cili nuk ka pjesëmarrje të mëparshme në kapitalin e një ndërmarrjeje rezidente, blen 10 për qind ose më shumë aksione të kësaj ndërmarrjeje, çmimi i aksioneve të siguruara duhet të regjistrohet si investim direkt. Nga ky moment, transaksionet e kapitalit të mëpastajme ndërmjet këtyre dy ndërmarrjeve, duhet të regjistrohen si investim direkt.

Investitorët direktë mund të jenë individë, ndërmarrje publike ose private të korporuara ose jo, një grup individësh ose ndërmarrjesh, qeveri ose agjenci të ndryshme qeveritare.

Kapitali i investimit direkt është (i) kapital i siguruar (në mënyrë direkte ose jo) nga një investitor direkt tek ndërmarrja që e përfiton këtë investim, ose (ii) kapital i marrë nga ndërmarrja prej një investitori direkt.

Përbërësit e kapitalit të investuar direkt janë kapitali i vet, fitimi i riinvestuar dhe çdo kapital tjetër që shoqëron transaksione të tjera borxhi.

- Kapitali i vet përfshin kapitalin në degë, të gjitha aksionet në degë ose filiale si dhe kontribute të tjera kapitali.
- Fitimi i riinvestuar janë aksionet e investitorit (në raport me pjesëmarrjen e tij në kapitalin e vet) të fitimit të pashpërndarë në formë dividendësh ose fitimi i realizuar nga degët por që nuk i ka kaluar investitorit direkt.

1.1 LLOGARITJA E STOKUT TË INVESTIMEVE DIREKTE

Në paraqitjen e statistikave të investimeve direkte mbahet parasysh fakti, që investimet direkte konsistojnë në lidhjet e kapitalit të huaj direkt, të lindura si rrjedhim i interesave pjesëmarrës të njëjësive jorezidente në ndërmarrjet brenda vendit. Në stokun e IHD-ve përfshihen përbërësit e mëposhtëm:

1. aksionet në kapitalin nominal (kapitali i nënshkruar) të zotëruara direkt nga aksionerët e huaj;

plus

2. pjesa në rezerva e kapitalit të huaj (rezervat e domosdoshme ligjore), si dhe në fitimet e mbartura për vitin pasardhës dhe në fitimet e vitit ushtrimor, për t'iu atribuar aksionerëve direktë. Këto ndarje përcaktohen proporcionalisht në bazë të aksioneve respektive të aksionerëve direktë individualë në kapitalin nominal;

minus

3. pjesa në humbjet e mbartura për vitin pasardhës dhe humbjet nga viti ushtrimor që u atribuohen aksionerëve direktë.

Agregimi i përbërësve të mësipërm jep kapitalin e investuar direkt.

Veç kësaj kapitali i investuar direkt përfshin:

4. huamarrjet/huadhëniet direkte ose indirekte të aksionerëve në vend ose jashtë vendit;

plus

5. huatë direkte nga ndërmarrjet e lidhura, domethënë investimet direkte jashtë - huatë nga ndërmarrjet e bashkuara në vend – dhe në rastin e investimeve direkte në vend – huatë nga ndërmarrjet e bashkuara me qendër (rezidencë) jashtë vendit.

Në llogaritjen e stokut të IHD-ve për këtë analizë, për mungesë informacioni statistikor janë përfshirë tre hapat e parë të përshkrimit të mësipërm.

2. KARAKTERISTIKA NUMERIKE TË NDËRMARRJEVE ME KAPITAL TË HUAJ NË VEND

2.1 INVESTIMET E HUAJA DIREKTE (IHD) SIPAS VENDIT TË ORIGINËS

Sipas vendit të origjinës Italia dhe Greqia ruajnë një pozicion mbizotërues në investimet e huaja direkte në Shqipëri. 51 për qind e ndërmarrjeve të investimit direkt janë me pjesëmarrje të kapitalit të huaj italian dhe 24 për qind me kapital të huaj grek. Ndjekësit më të afërt janë kapitali turk (4 për qind) dhe ai amerikan (3 për qind) (tabela 1). Ndërkohë, vërejmë një hapje drejt Kinës dhe Lindjes së Mesme, shoqëruar edhe me rritjen e flukseve të kapitalit nga këto vende.

Vendi i origjinës	Nr. i ndërmarrjeve	Përqindja
Bashkimi Evropian	434	82.5%
Angli	3	0.6%
Austri	3	0.6%
Belgjikë	1	0.2%
Bullgari	2	0.4%
Francë	4	0.8%
Greqi	128	24.3%
Gjermani	9	1.7%
Hollandë	2	0.4%
Hungari	7	1.3%
Itali	269	51.1%
Maltë	1	0.2%
Qipro	2	0.4%
Slloveni	2	0.4%
Suedi	1	0.2%
Vendet e Rajonit	40	7.6%
Kroaci	4	0.8%
Kosovë	6	1.1%
Maqedoni	8	1.5%
Serbi dhe Mal i Zi	2	0.4%
Turqi	20	3.8%

Tabelë 1. Investimet e huaja direkte sipas vendit të origjinës.

Lindja e Mesme	15	2.9%
Arabi Saudite	3	0.6%
Egjipt	3	0.6%
Kuvajit	1	0.2%
Liban	6	1.1%
Izrael	1	0.2%
Siri	1	0.2%
Lindja e Largët	10	1.9%
Kinë	10	1.9%
Australi	1	0.2%
Shtetet e Bashkuara të Amerikës	14	2.7%
Kanada	2	0.4%
Institucione ndërkombëtare	2	0.4%
Zvicër	2	0.4%
Të tjera	6	1.1%
Totali	526	100.0%

Burimi: Banka e Shqipërisë.



2.2 DINAMIKA E KRIJIMIT TË NDËRMARRJEVE TË REJA ME KAPITAL TË HUAJ

Frekuenca e hapjes së ndërmarrjeve të IHD në Shqipëri sikurse pritej, ka ndjekur prirjet e zhvillimit ekonomik të vendit që pas hapjes së tij për kapitalin e huaj. Kombet e Bashkuara² citojnë vitin 1990, si vit në të cilin legjislacioni shqiptar ka lejuar, për herë të parë, hapjen e vendit ndaj investimeve të huaja direkte. Krijimi i ndërmarrjeve të reja me pjesëmarrje të kapitalit të huaj në vend ka ardhur në rritje gjatë viteve të para të tranzicionit, duke pësuar tkurrje gjatë krizës social-ekonomike të vitit 1997 (grafik 1). Më pas, kjo prirje ka qenë më e moderuar, ndikuar gjithashtu nga situata përgjithësisht problematike në Ballkan. Viti 2004 shfaqet si një vit me tendenca pozitive në këtë drejtim.


2.3 SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE E INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE

Përsa i përket shpërndarjes gjeografike të IHD në Shqipëri, vihet re një përqëndrim i tyre në Tiranë dhe në pjesën perëndimore të vendit (grafiku 2 dhe tabela 1 në aneksin bashkëngjitur). Zonat ku janë përqëndruar IHD janë zona me të ardhura më të larta dhe infrastrukturë më të zhvilluar. Pjesa e brendshme qendrore si dhe verilindja e vendit, janë ndër zonat më pak të preferuara nga investitorët e huaj. Përveç infrastrukturës së pazhvilluar të këtyre zonave dhe marketingut të munguar, një rol të rëndësishëm mendohet të ketë luajtur migrimi i brendshëm dhe i jashtëm, i cili vështirëson gjetjen e fuqisë punëtore të kualifikuar në to. Megjithatë, një përqindje të konsiderueshme të IHD kemi në rrethe kufitare me Greqinë, si Korça dhe Gjirokastra.

2.4 PËRQËNDRIMI I FUQISË PUNËTORE

Në aspektin e punësimit mund të flitet për shpërpjesëtim ndërmjet madhësisë së ndërmarrjeve dhe fuqisë punëtore, të punësuar në to. Kështu, ndërkohë që rreth 46 për qind e ndërmarrjeve (tabela 2) janë me nga 1-9 të punësuar, vetëm 4 për qind e punësimit realizohet nga këto ndërmarrje. Nga ana tjetër, ndërmarrjet me më tepër se 100 të punësuar përfaqësojnë vetëm 12 për qind të ndërmarrjeve IHD në Shqipëri, duke punësuar rreth 61 për qind të fuqisë punëtore në to. Kjo tregon se IHD në Shqipëri janë të përqëndruara më tepër, në sektorë me përdorim intensiv të fuqisë punëtore, gjë që shihet qartë edhe në përqëndrimin e IHD sipas sektorëve.

Grafik 2. Shpërndarja zonale e IHD-ve në Shqipëri.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ndërmarrje me nga:	Numri i ndërmarrjeve	%	Numri i të punësuarve	%
1-9 të punësuar	238	46	901	4
10-50 të punësuar	171	33	4274	19
51-100 të punësuar	50	10	3777	17
mbi 100 të punësuar	62	12	13723	61
Totali	521	100	22675	100


Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabela 2. Përqëndrimi i fuqisë punëtore.

2.5 PJESËMARRJA E KAPITALIT TË HUAJ

Në rreth 66 për qind të ndërmarrjeve, pjesëmarrja e kapitalit të huaj është në intervalin 75-100 për qind të kapitalit të nënshkruar (grafiku 3). Bie në sy prezenca relativisht më e lartë e kapitalit të huaj në ndërmarrjet me më tepër të punësuar. Ndërmarrjet e zotëruara totalisht nga investitorë të huaj përbëjnë 56 për qind të ndërmarrjeve të vrojtura.

Grafik 3. Intervalet e pjesëmarrjes së kapitalit të huaj.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.6 INVESTIME TË HUAJA DIREKTE SIPAS SEKTORËVE TË EKONOMISË

Shpërndarja sektoriale e investimeve të huaja direkte në Shqipëri tregon një shkallë të lartë përqëndrimi të tyre në industrinë përpunuese dhe fushat e tregtisë me shumicë (tabela 3).

Pra, investimet kanë qenë më të shpeshta në sektorë me prurje të shpejtë fitimi (shlyerje të shpejtë të investimit). Këto investime mund të konsiderohen të paqëndrueshme, të tilla që ndryshojnë shpejt vendndodhjen gjeografike dhe sektorin ku veprojnë.

Ndërkohë, investimet në industrinë përpunuese, e cila përfaqësohet me industrinë tekstilë të veshjeve dhe të këpucëve, synojnë sektorët me përqëndrim të lartë të fuqisë punëtore dhe jo ato me përqëndrim kapitali ose teknologjike. Kështu, roli i këtyre investimeve në përmirësimet teknologjike të prodhimit në vend, ka më pak efekte pozitive në sektorë të tjerë të prodhimit. Kjo e fundit shpegohet edhe me kërkesën brendshme të rritur për mallra me cikël konsumi të shkurtër.

Duke kombinuar këto rezultate me ato të punësimit, arrijmë në përfundimin që investimet në industri kanë synuar sektorët me përqëndrim të lartë të fuqisë punëtore dhe jo ato me përqëndrim të kapitalit ose të teknologjisë. Kjo i lë pak hapësirë rolit të investimeve të huaja në transferimin e teknologjisë dhe rritjen e kapacitetit teknologjik të prodhimit në vend, duke minimizuar efektet pozitive anësore të këtyre investimeve në sektorët e tjerë të prodhimit.

(Shpërndarja analitike e klasifikimit të ndërmarrjeve sipas sektorëve ekonomikë jepet në tabelën 2, në aneksin bashkëngjitur.)

Tabelë 4. Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas sektorëve (bazuar në Nomenklaturën e Veprimeve Ekonomike Rev. 1.1 INSTAT).

Seksioni	Përshkrimi	Numër ndërmarrjesh	%
A	Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	3	1
B	Peshkimi	3	1
C	Industria nxjerrëse	12	2
D	Industria përpunuese	234	45
E	Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit, avullit dhe e ujit të ngruhtë	2	0
F	Ndërtimi	41	8
G	Tregtia me shumicë dhe me pakicë, riparimi i automobilave, motoçikletave, i sendeve personale dhe i pajisjeve shtëpiake	142	27
H	Hotele dhe restorante	7	1
I	Transporte, magazinimi dhe komunikacioni	24	5
J	Ndërmjetësimi monetar dhe financiar	4	1
K	Pasuritë e patundshme, dhënia me qira, informatika, puna kërkimore shkencore, të tjera aktivitete personale	24	5
L	Administrimi publik dhe i mbrojtjes, sigurimi shoqëror i detyruar	0	0
M	Arsimi	4	1
N	Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale	5	1
O	Aktivitete të tjera të shërbimit social dhe individual	15	3
P	Shërbime në shtëpi	0	0
Q	Aktivitete të organizmave ndërkombëtarë	0	0
	n.a	1	0
	TOTALI	521	100

Burimi: Banka e Shqipërisë.

3. KARAKTERISTIKA SASIORE TË INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE

3.1 STOKU I KAPITALIT TË HUAJ

Nisur nga informacioni i disponueshëm si dhe bazuar në metodologjinë e shpjeguar më sipër stoku i kapitalit të huaj, në formën e investimeve direkte, për vitin 2004 vlerësohet në nivelin 38 miliardë lekë.

Gjatë vitit 2004 kanë filluar aktivitetin rreth 48 ndërmarrje të reja të investimit direkt, duke sjellë një fluks të ri të kapitalit të huaj prej 28.6 milionë lekësh. Ky fluks kapitali është thithur kryesisht nga sektorët e fabrikimit të veshjeve, të tregtisë me shumicë të mallrave ushqimorë etj..

Gjithashtu, gjatë vitit 2004 në mëse 12 për qind të ndërmarrjeve të intervistuar, asamblatë aksionere kanë marrë vendime për rritjen e kapitalit të nënshkruar, duke rritur kapitalin e huaj në Shqipëri me rreth 5 miliardë lekë. Duket se investitorët e huaj po vlerësojnë klimën e investimeve në vend. Fitimi i riinvestuar përgjatë vitit 2004 vlerësohet të jetë 10 miliardë lekë, konsiderueshëm në rritje përkundrejt një viti më parë dhe ruan nivelin më të lartë për periudhën që po analizojmë.


3.2 ORIGJINA E KAPITALIT TË HUAJ

Investitorët nga vendet e Bashkimit Evropian dominojnë investimet e huaja direkte në Shqipëri. Në fund të vitit 2004, jo më pak se 82 për qind e stokut të investimeve të huaja ishte për llogari të vendeve të Bashkimit Evropian, me investitorë kryesorë Greqinë (me 48 për qind të stokut të kapitalit të huaj në fund të vitit 2004) dhe Italinë (me 30 për qind). (Grafiku 4 dhe tabela 3 në aneksin bashkëngjitur.) Investitorë domethënës, mes vendeve të tjera jashtë këtij grupi (BE), janë vetëm Turqia dhe Libani.

Greqia dhe Italia kanë rritur ndjeshëm praninë e tyre në stokun e kapitalit të huaj në vend. Afërsia gjeografike e Shqipërisë me këto dy vende si dhe një bashkëpunim i fuqishëm ekonomik me BE, janë ndër arsyet kryesore për dominimin e investitorëve të huaj nga këto vende.


Rritja e stokut të kapitalit të huaj në vite, vërehet të ketë qenë më e ndjeshme përse i përket kapitalit grek. Ky i fundit, në fund të vitit 2004 vlerësohet në rreth 18 miliardë lekë nga 7 miliardë lekë vlerësuar në fund të vitit 2001. (Grafiku 5.) Kapitali grek është i përqëndruar kryesisht në sektorin e komunikacionit (68 për qind) ardhur si rezultat i përfshirjes në privatizime gjatë viteve 2000-2001 dhe tregtisë me shumicë (13 për qind). Përgjatë viteve të fundit është zbehur disi prania e tij në industrinë e veshjeve.

Grafik 4. Stoku i kapitalit të huaj në vite (në miliardë lekë).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 5. Stoku i kapitalit të huaj sipas origjinës për vitin 2004.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 6. Ecuria e stokut të kapitalit të huaj sipas origjinës (në miliardë lekë).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kapitali italian për periudhën e vrojtuar (2001-2004), ka ruajtur rreth intervaleve 60-65 për qind përfaqësimin e tij me investime në industrinë përpunuese. Në fund të vitit 2004, stoku i kapitalit italian vlerësohet në rreth 11.3 miliardë lekë nga 3.8 miliardë lekë në vitin 2001.

3.3 SHPËRNDARJA SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK

Me rreth 36 për qind të stokut të IHD-ve në fund të vitit 2004 si dhe 45 për qind të numrit të ndërmarrjeve të huaja, industria përpunuese është sektori kryesor tërheqës i investimeve të huaja në Shqipëri (tabela 5.). Brenda saj, kapitali i huaj në mëse 65 për qind të tij, është me destinacion në industrinë tekstile dhe të veshjeve, përpunimit ushqimor, fabrikimit të mobilieve etj.. Industrinë përpunuese me përdorim të teknologjisë (si për shembull, mjekësore dhe farmaceutike, makineri e pajisje elektrike dhe elektronika) dhe ato me përdorim të kapitalit (si për shembull, rafineri naftë, materiale kimike) thuajse ndajnë pjesën e mbetur. Kjo sugjeron që një motivim i rëndësishëm për kompanitë e huaja ka qenë përparësia e fuqisë së lirë punëtore.

Sektori i komunikacionit, me vetëm 5 subjekte, përfaqëson rreth 33 për qind të gjendjes së kapitalit të huaj në fund të vitit 2004. Privatizimet e viteve 2000-2001 kanë tërhequr investitorë potencialë në këtë fushë. Më pas, kapitali i huaj në këtë sektor ka shfaqur prirje në rritje, si në aspektin e kapitalit themeltar të kompanive ashtu edhe në atë të riinvestimit të fitimeve dhe investimeve të bëra gjatë vitit ushtrimor.

Zhvillimet e vullshme në sektorin e ndërtimit, gjatë viteve të fundit, po tërheqin vëmendjen e investitorëve të huaj. Prania e kapitalit të huaj në këtë sektor është rritur ndjeshëm përgjatë dy viteve të fundit, duke sjellë me vete flukse të reja të kapitalit të huaj edhe në fusha të tjera mbështetëse të tij, si për shembull në aktivitete arkitektonike dhe inxhinierike (klasifikuar nën seksionin K në tabelën 5).

Tabelë 5. Shpërndarja e stokut të kapitalit të huaj sipas sektorëve (bazuar në Nomenklaturën e Veprimeve Ekonomike Rev. 1.1 INSTAT) në përqindje .

Seksioni	Përshkrimi	2001	2002	2003	2004
					%
A	Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	0.8	0.6	0.4	0.5
B	Peshkimi	0.0	0.0	0.0	0.0
C	Industria nxjerrëse	3.0	1.9	1.2	1.2
D	Industria përpunuese	33.1	31.7	37.8	36.3
E	Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit, avullit dhe e ujit të ngrrohtë	0.0	0.5	0.3	0.2
F	Ndërtimi	4.8	4.7	5.6	5.6
G	Tregtia me shumicë dhe me pakicë, riparimi i automobilave, motoçikletave, i sendeve personale dhe i pajisjeve shtëpiake	10.4	6.8	5.6	9.6
H	Hotele dhe restorantet	6.7	5.5	3.4	3.0
I	Transporte, magazinimi dhe komunikacioni	35.8	43.0	38.9	36.9
J	Ndërmjetësimi monetar dhe financiar	4.4	3.8	2.7	2.4
K	Pasuritë e patundshme, dhënia me qira, informatika, puna kërkimore shkencore, të tjera aktivitete personale	0.2	1.0	2.7	3.3

L	Administrimi publik dhe i mbrojtjes, sigurimi shoqëror i detyruar	0.0	0.0	0.0	0.0
M	Arsimi	0.0	0.0	0.1	0.1
N	Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale	0.0	0.0	0.0	0.1
O	Aktivitete të tjera të shërbimit social dhe individual	0.5	0.4	1.1	0.9
P	Shërbime në shtëpi	0.0	0.0	0.0	0.0
Q	Aktivitete të organizmave ndërkombëtarë	0.0	0.0	0.0	0.0
	n.a.	0.3	0.2	0.1	0.1
	TOTALI	100.0	100.0	100.0	100.0

Burimi: Banka e Shqipërisë.

(Shpërndarja analitike e stokut të kapitalit të huaj sipas sektorëve ekonomikë jepet në tabelën 4, në aneksin bashkëngjitur.)

3.4 INVESTIMET GJATË VITIT USHTRIMOR 2004

Nga të dhënat e disponueshme për ndërmarrjet që kanë raportuar lidhur me investimet e kryera gjatë vitit ushtrimor 2004, rezulton se rreth 100 përqind e fluksit të investimit ka shkuar për aktive të qëndrueshme.

Totali i investimeve të kryera kap shifrën 15 miliardë lekë nga ku investimet e lidhura me kuotën e investitorit të huaj vlerësohen në rreth 14 miliardë lekë. Më shumë se gjysma e totalit të investimeve të ushtrimit ka shkuar për instalime teknike, makineri dhe pajisje.

Investime gjithsej (I+II)	100.0
I. Të patrupëzuara	0.1
II. Të trupëzuara	99.9
nga të cilat	
1. Për tokë, troje, terrene	1.7
2. Për ndërtesa	3.7
3. Ndërtime dhe instalime të përgjithshme	22.6
4. Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla	51.6
5. Mjete transporti	3.2
6. Pajisje zyre dhe informatike	2.5
7. Të tjera	14.7

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 6. Struktura e investimeve të kryera gjatë vitit ushtrimor 2003.

Industria përpunuese rezulton sektori me flusin më të madh të investimeve gjatë vitit ushtrimor 2004, rreth 42 përqind të tyre, e ndjekur nga sektori i komunikacionit me rreth 39 përqind.

Seksioni	Përshkrimi	%
A	Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	0.2
B	Peshkimi	0.0
C	Industria nxjerrëse	2.0
D	Industria përpunuese	42.2
E	Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit, avullit dhe e ujit të ngrohtë	0.5
F	Ndërtimi	1.3

Tabelë 7. Shpërndarja strukturore e investimeve të kryera gjatë vitit ushtrimor 2004 sipas sektorëve të ekonomisë.

G	Tregtia me shumicë dhe me pakicë, riparimi i automobilave, motoçikletave, i sendeve personale dhe i pajisjeve shtëpiake	10.4
H	Hotele dhe restorante	0.5
I	Transporte, magazinimi dhe komunikacioni	38.5
J	Ndërmjetësimi monetar dhe financiar	0.0
K	Pasuritë e patundshme, dhënia me qira, informatika, puna kërkimore shkencore, të tjera aktivitete personale	2.9
L	Administrimi publik dhe i mbrojtjes, sigurimi shoqëror i detyruar	0.0
M	Arsimi	1.0
N	Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale	0.2
O	Aktivitete të tjera të shërbimit social dhe individual	0.3
P	Shërbime në shtëpi	0.0
Q	Aktivitete të organizmave ndërkombëtarë	0.0
	TOTALI	0.0

Burimi: Banka e Shqipërisë.

ANEKS

Tabelë 1. Shpërndarja zonale e ndërmarrjeve të investimit direkt në Shqipëri.

Nr.	Qarqet (Prefekturat)	Nr.	Rrethet	Ndërmarrje të huaja aktive
1	Berat			7
		1	Berat	7
		2	Kucovë	
		3	Skrapar	
2	Dibër			0
		4	Dibër	
		5	Mat	
		6	Bulqizë	
3	Durrës			76
		7	Durrës	68
		8	Krujë	8
4	Elbasan			21
		9	Elbasan	20
		10	Peqin	
		11	Gramsh	
		12	Librazhd	1
5	Fier			24
		13	Fier	20
		14	Mallakastër	
		15	Lushnje	4
6	Gjirokastrë			19
		16	Gjirokastrë	18
		17	Tepelenë	
		18	Përmet	1
7	Korçë			52
		19	Korçë	48
		20	Devoll	1
		21	Kolonjë	1
		22	Pogradec	2
8	Kukës			0
		23	Kukës	
		24	Has	
		25	Tropojë	
9	Lezhë			5
		26	Lezhë	5
		27	Kurbini	
		28	Mirditë	
10	Shkodër			23
		29	Shkodër	23
		30	Malësi e Madhe	
		31	Pukë	
11	Tiranë			273
		32	Tiranë	271
		33	Kavajë	2
12	Vlorë			21
		34	Vlorë	17
		35	Sarandë	2
		36	Delvinë	2
	Gjithsej	36		521

Tabelë 2. Shpërndarja e kompanive sipas sektorëve (bazuar në Nomenklaturën e Veprimeve Ekonomike Rev. 1.1 INSTAT).

Ndarja/ grupi	Përshkrimi	NR	%
A	Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	3	1
'01	Bujqësia, gjuetia dhe shërbime plotësuese	2	0
'02	Silvikultura,shfrytëzimi i pyjeve, shërbime plotësuese	1	0
B	Peshkimi	3	1
'05	Peshkimi, kultivimi i peshkut dhe shërbimet në lidhje me peshkimin	3	1
C	Industria nxjerrëse	12	2
CA	Nxjerrja e mineraleve energjitike	3	1
'10	Nxjerrja e qymyrgurit dhe e linjiteve;nxjerrja e torfës	0	-
'11	Nxjerrja e naftës bruto, gazit natyror, shërbimeve plotësuese në nxjerrjen e naftës dhe të gazit, përveç studimeve gjeologjike	3	1
'12	Nxjerrja e mineralit të uranimit dhe toriumit	0	-
CB	Nxjerrja e mineraleve joenergjitike	9	2
'13	Nxjerrja e mineraleve metalike	0	-
'14	Industri të tjera nxjerrëse	9	2
D	Industria përpunuese	234	45
DA	Industria ushqimore, e pijeve dhe e duhanit	14	3
'15	Industria ushqimore dhe e pijeve	12	2
'16	Industria e duhanit	2	0
DB	Industria tekstile dhe e veshjeve	92	18
'17	Industria e tekstileve	3	1
'18	Industria e veshjeve dhe e gëzofëve	89	17
DC	Industria e lëkurës dhe e këpucëve	29	6
'19	Përgatitja, tanini i lëkurës, fabrikimi i artikujve të udhëtimit dhe të galanterisë, fabrikimi i pajimeve të kuajve dhe fabrikimi i këpucëve	29	6
DD	Punimet me dru dhe fabrikimi i artikujve prej druri	8	2
'20	Industria e drurit dhe e artikujve me dru përveç fabrikimit të mobilieve, shporterisë dhe të xunkthit	8	2
DE	Fabrikimi i brumit të letrës, i letrës dhe artikujve prej letre; shtypshkronja dhe botimi	10	2
'21	Fabrikimi i brumit të letrës, i letrës dhe artikujve prej letre dhe kartoni	4	1
'22	Botimi, shtypshkronja dhe riprodhimi i suporteve të regjistruara	6	1
DF	Koksifikimi, rafinimi i naftës, industria bërthamore	0	-
'23	Koksifikimi, rafinimi i naftës, industria bërthamore	0	-
DG	Industria kimike	7	1
'24	Industria kimike	7	1
DH	Industria e gomës dhe e plastikës	12	2
'25	Industria e gomës dhe e plastikës	12	2
DI	Fabrikimi i artikujve të tjerë minerale jo metalike	20	4
'26	Fabrikimi i artikujve të tjerë mineralë dhe jo metalikë	20	4
DJ	Metalurgjia dhe punimi i metaleve	14	3
'27	Siderurgjia	2	0
'28	Punime me metale	12	2
DK	Fabrikimi i makinave dhe pajisjeve përfshirë instalimin, montimin, riparimin dhe mirëmbajtjen	1	0
29	Fabrikimi i makinave dhe pajisjeve përfshirë instalimin, montimin, riparimin dhe mirëmbajtjen	1	0
DL	Fabrikimi i pajisjeve elektrike dhe optike	10	2
30	Fabrikimi i makinave të zyrave, të makinave llogaritëse dhe të pajisjeve të trajtimit të informacionit	0	-
31	Fabrikimi i makinave dhe pajisjeve elektrike	7	1
32	Fabrikimi i aparaturave radiotelevizive dhe i atyre të komunikacionit	1	0
33	Fabrikimi i pajisjeve mjekësore, të precizionit , instrumenteve optike dhe orëve	2	0
DH	Fabrikimi i mjeteve të transportit	1	0
34	Fabrikimi i automjeteve, rimorkiove dhe gjysmë rimorkiove	0	-
35	Fabrikimi i mjeteve të tjera të transportit	1	0
DN	Industri të tjera përpunuese	16	3
36	Fabrikimi i mobilieve, industri të ndryshme	16	3
37	Grumbullimi dhe përgatitja për riciklim	0	-
E	Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit, avullit dhe e ujit të ngrohtë	2	0
40	Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit, avullit dhe e ujit të ngrohtë	1	0
41	Depozitimi, pastrimi dhe shpërndarja e ujit	1	0
F	Ndërtimi	41	8

45	Ndërtimi	41	8
G	Tregtia me shumicë dhe me pakicë. Riparimi i automobilave, motoçikletave, i sendeve personale dhe i pajisjeve shtëpiake	142	27
50	Tregtimi, mirëmbajtja dhe riparimi i automobilave dhe motoçikletave	8	2
51	Tregtia me shumicë dhe ndërmjetësimi tregtar (përveç mjeteve të transportit automobilistik)	108	21
52	Tregtia me pakicë ; riparimi i artikujve personalë dhe shtëpiake	26	5
H	Hotele dhe restorante	7	1
55	Hotele dhe restorante	7	1
I	Transporte, magazinimi dhe komunikacioni	24	5
60	Transporti tokësor; transporti nëpërmjet tubacioneve	4	1
61	Transporti ujor	2	0
62	Transporti ajror	3	1
63	Shërbime ndihmëse në transport; aktivitete të agjencive të udhëtimit	10	2
64	Postat dhe komunikacionet	5	1
J	Ndërmjetësimi monetar dhe financiar	4	1
65	Ndërmjetësimi monetar dhe financiar përveç aktiviteteve siguroese si dhe фондеве të pensioneve	2	0
66	Aktivitete siguroese dhe të фондеве të pensioneve, përveç sigurimeve shoqërore të detyrueshme	2	0
67	Aktivitete ndihmëse të ndërmjetësitit financiar dhe atyre siguroese		-
K	Pasuritë e patundshme, dhënia me qira, informatika, puna kërkimore shkencore, të tjera aktivitete personale	24	5
70	Aktivitete të pasurive të patundshme	9	2
71	Dhënia me qira e pajisjeve pa operator dhe e artikujve personalë dhe shtëpiake	2	0
72	Aktivitete informatike dhe aktivitete të lidhura me to	2	0
73	Kërkime-aplikime eksperimentale	0	-
74	Aktivitete të tjera profesionale	11	2
L	Administrimi publik dhe i mbrojtjes, sigurimi shoqëror i detyruar	0	-
75	Administrimi publik dhe i mbrojtjes, sigurimi shoqëror i detyruar	0	-
M	Arsimi	4	1
80	Arsimi	4	1
N	Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale	5	1
85	Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale	5	1
O	Aktivitete të tjera të shërbimit social dhe individual	15	3
90	Pastrimi, heqja e mbeturinave, trajtimi i hedhurinave dhe aktivitete të tjera të ngjashme	2	0
91	Aktivitete të organizatave të ndryshme shoqërore	6	1
92	Aktivitete dëfrimi, kulturore dhe sportive	6	1
93	Aktivitete të shërbimeve personale	1	0
P	Shërbime në shtëpi	0	-
95	Shërbime në shtëpi	0	-
96	Aktivitete të prodhimit të mallrave të pandryshuar të familjeve private për përdorimin e vet	0	-
97	Aktivitete të prodhimit të shërbimeve të pandryshuara të familjeve private për përdorimin e vet	0	-
Q	Aktivitete të organizmave ndërkombëtarë	0	-
99	Aktivitete të organizmave ndërkombëtare	0	-
	Na	1	
Total		521	100

Tabelë 3. Origjina e kapitalit të huaj.
(gjendja e stokut në fund të periudhës, në mijë lekë).

Vendi i origjinës	2001	%	2002	%	2003	%	2004	%
Bashkimi Evropian nga të cilat	12,197,774	77	15,119,893	79	25,641,738	82	31,085,736	82
Austri	873,285	5	873,390	5	874,102	3	874,117	2
Greqi	6,973,210	44	9,205,083	48	13,906,849	45	18,139,697	48
Gjermani	290,252	2	388,130	2	382,921	1	369,613	1
Itali	3,760,558	24	4,410,597	23	9,896,521	32	11,314,441	30
Të tjera	300,469	2	242,693	1	581,346	2	387,868	1
Vendet e Rajonit nga të cilat	1,210,619	8	1,251,390	6	2,048,256	7	3,152,459	8
Kroaci	178,110	1	178,110	1	281,907	1	325,792	1

Kosovë	51,243	0	77,060	0	92,608	0	115,890	0
Maqedoni	278,968	2	247,644	1	849,865	3	898,669	2
Turqi	702,246	4	748,523	4	816,074	3	1,803,815	5
Të tjera	53	0	53	0	7,801	0	8,292	0
Lindja e Mesme nga të cilat	1,521,447	10	1,932,085	10	1,882,647	6	1,972,923	5
Egjipt	527,980	3	528,674	3	529,955	2	543,731	1
Liban	991,429	6	1,401,013	7	1,350,110	4	1,354,149	4
Të tjera	2,039	0	2,398	0	2,582	0	75,043	0
Lindja e Largët	777	0	777	0	38,306	0	13,515	0
Kina	777	0	777	0	38,306	0	13,515	0
Shtetet e Bashkuara të Amerikës	278,441	2	327,376	2	890,437	3	757,264	2
Institucione ndërkombëtare	696,269	4	696,269	4	696,269	2	696,269	2
Të tjera	13,146	0	-72,784	0	12,804	0	29,994	0
Totali	15,918,473	100	19,255,005	100	31,210,458	100	37,708,160	100

Tabelë 4. Shpërndarja e kompanive sipas sektorëve (bazuar në Nomenclaturën e Veprimeve Ekonomike Rev. 1.1 INSTAT). (gjendja e stokut në fund të periudhës, në mijë lekë).

Ndarja/ grupi	Përshkrimi	2001	2002	2003	2004
A	Bujqësia, gjuetia dhe silvikultura	122,599	123,642	122,187	177,435
'01	Bujqësia, gjuetia dhe shërbime plotësuese	122,450	123,493	122,038	177,285
'02	Silvikultura,shfrytëzimi i pyjeve, shërbime plotësuese	150	150	150	150
B	Peshkimi	3,871	5,400	5,301	5,157
'05	Peshkimi, kultivimi i peshkut dhe shërbimet në lidhje me peshkimin	3,871	5,400	5,301	5,157
C	Industria nxjerrëse	478,818	367,904	369,849	446,866
CA	Nxjerrja e mineraleve energjitike	3,051	-78,139	-15,339	-3,072
'10	Nxjerrja e qymyrgurit dhe e linjiteve;nxjerrja e torfës				
'11	Nxjerrja e naftës bruto, gazit natyror, shërbimeve plotësuese në nxjerrjen e naftës dhe të gazit, përveç studimeve gjeologjike	3,051	-78,139	-15,339	-3,072
'12	Nxjerrja e mineralit të uraniumit dhe toriumit				
CB	Nxjerrja e mineraleve joenergjitike	475,767	446,042	385,188	449,938
'13	Nxjerrja e mineraleve metalike				
'14	Industri të tjera nxjerrëse	475,767	446,042	385,188	449,938
D	Industria përpunuese	5,276,885	6,097,960	11805036.97	13,701,582
DA	Industria ushqimore, e pijeve dhe e duhanit	1,087,117	1,122,912	4,890,497	4,071,129
'15	Industria ushqimore dhe e pijeve	898,688	928,740	4,704,788	3,884,379
'16	Industria e duhanit	188,430	194,172	185,708	186,749
DB	Industria tekstile dhe e veshjeve	1,016,115	1,193,020	1,325,668	1,440,979
'17	Industria e tekstileve	26,442	26,303	22,946	23,705
'18	Industria e veshjeve dhe e gëzofëve	989,673	1,166,717	1,302,722	1,417,274
DC	Industria e lëkurës dhe e këpucëve	281,515	302,533	442,715	450,686
'19	Përgatitja, tanini i lëkurës, fabrikimi i artikujve të udhëtimit dhe të galanterisë, fabrikimi i pajimeve të kuajve dhe fabrikimi i këpucëve	281,515	302,533	442,715	450,686
DD	Punimet me dru dhe fabrikimi i artikujve prej druri	183,867	184,927	306,678	280,800
'20	Industria e drurit dhe i artikujve me dru përveç fabrikimit të mobilieve, shporterisë dhe të xunkthit	183,867	184,927	306,678	280,800

DE	Fabrikimi i brumit të letrës, i letrës dhe artikujve prej letre; shtypshkronja dhe botimi	10,673	7,491	16,082	53,428
'21	Fabrikimi i brumit të letrës, i letrës dhe artikujve prej letre dhe kartoni	210	222	690	34,711
'22	Botimi, shtypshkronja dhe riprodhimi i suporteve të regjistruara	10,463	7,269	15,392	18,717
DF	Koksifikimi, rafinimi i naftës, industria bërthamore	0	0	0	0
'23	Koksifikimi, rafinimi i naftës, industria bërthamore				
DG	Industria kimike	68,158	70,855	73,613	85,881
'24	Industria kimike	68,158	70,855	73,613	85,881
DH	Industria e gomës dhe e plastikës	136,086	139,851	289,950	278,368
'25	Industria e gomës dhe e plastikës	136,086	139,851	289,950	278,368
DI	Fabrikimi i artikujve të tjerë mineralë jometalikë	1,447,380	1,940,798	2,804,110	3,678,295
'26	Fabrikimi i artikujve të tjerë mineralë dhe jometalikë	1,447,380	1,940,798	2,804,110	3,678,295
DJ	Metalurgjia dhe punimi i metaleve	588,372	497,227	598,430	1,739,017
'27	Siderurgjia	415,200	282,455	294,411	913,092
'28	Punime me metale	173,172	214,772	304,019	825,925
DK	Fabrikimi i makinave dhe pajisjeve përfshirë instalimin, montimin, riparimin dhe mirëmbajtjen	105	371	105	1,266
29	Fabrikimi i makinave dhe pajisjeve përfshirë instalimin, montimin, riparimin dhe mirëmbajtjen	105	371	105	1,266
DL	Fabrikimi i pajisjeve elektrike dhe optike	8,143	8,008	382,507	913,872
30	Fabrikimi i makinave të zyrave, të makinave llogaritëse dhe të pajisjeve të trajtimit të informacionit				
31	Fabrikimi i makinave dhe pajisjeve elektrike	7,985	7,735	381,700	913,143
32	Fabrikimi i aparaturave radiotelevizive dhe i atyre të komunikacionit	105	105	105	105
33	Fabrikimi i pajisjeve mjekësore, të precizionit, instrumenteve optike dhe orëve	53	168	702	624
DH	Fabrikimi i mjeteve të transportit	372,795	548,024	586,110	610,119
34	Fabrikimi i automjeteve, rimorkiove dhe gjysmë rimorkiove				
35	Fabrikimi i mjeteve të tjera të transportit	372,795	548,024	586,110	610,119
DN	Industri të tjera përpunuese	76,560	81,944	88,572	97,743
36	Fabrikimi i mobilieve, industri të ndryshme	76,560	81,944	88,572	97,743
37	Grumbullimi dhe përgatitja për riciklim				
E	Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit, avullit dhe e ujit të ngrohtë	105	87,204	87,204	87,204
40	Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit, avullit dhe e ujit të ngrohtë	0	54	54	54
41	Depozitimi, pastrimi dhe shpërndarja e ujit	105	87,150	87,150	87,150
F	Ndërtimi	762,983	900,195	1,749,458	2,093,426
45	Ndërtimi	762,983	900,195	1,749,458	2,093,426
G	Tregtia me shumicë dhe me pakicë. Riparimi i automobilitave, motoçikletave, i sendeve personale dhe i pajisjeve shtëpiake	1,659,806	1,300,980	1,743,499	3,609,569
50	Tregtimi, mirëmbajtja dhe riparimi i automobilitëve dhe motoçikletave	83,675	70,782	85,795	95,081
51	Tregtia me shumicë dhe ndërmjetësimi tregtar (përveç mjeteve të transportit automobilistik)	1,549,288	1,202,486	1,567,595	3,409,868
52	Tregtia me pakicë; riparimi i artikujve personalë dhe shtëpiake	26,843	27,712	90,109	104,621

H	Hotele dhe restorante	1,062,455	1,062,730	1,066,422	1,130,254
55	Hotele dhe restorante	1,062,455	1,062,730	1,066,422	1,130,254
I	Transporte, magazinimi dhe komunikacioni	5,692,778	8,278,967	12152996.8075	13,896,890
60	Transporti tokësor; transporti nëpërmjet tubacioneve	16,362	18,678	21,981	259,975
61	Transporti ujor	5,167	-14,078	5,357	-125,036
62	Transporti ajror	929,905	976,537	984,347	1,343,694
63	Shërbime ndihmëse në transport; aktivitete të agjencive të udhëtimit	11,692	12,309	21,778	16,181
64	Postat dhe komunikacionet	4,729,653	7,285,521	11,119,534	12,402,076
J	Ndërmjetësimi monetar dhe financiar	705,069	726,789	848,860	893,634
65	Ndërmjetësimi monetar dhe financiar përveç aktiviteteve siguruese si dhe fondeve të pensioneve	1,155	1,155	104,952	148,836
66	Aktivitete siguruese dhe të fondeve të pensioneve, përveç sigurimeve shoqërore të detyrueshme	703,914	725,634	743,908	744,797
67	Aktivitete ndihmëse të ndërmjetësimit financiar dhe atyre siguruese				
K	Pasuritë e patundshme, dhënia me qira, informatika, puna kërkimore shkencore, të tjera aktivitete personale	28,650	186,855	848,618	1,226,813
70	Aktivitete të pasurive të patundshme	21,567	42,678	678,499	713,149
71	Dhënia me qira e pajisjeve pa operator dhe e artikujve personalë dhe shtëpiakë	2,100	137,795	139,761	142,835
72	Aktivitete informatike dhe aktivitete të lidhura me to	0	0	0	210
73	Kërkime-aplikime eksperimentale				
74	Aktivitete të tjera profesionale	4,982	6,382	30,358	370,620
L	Administrimi publik dhe i mbrojtjes, sigurimi shoqëror i detyruar	0	0	0	0
75	Administrimi publik dhe i mbrojtjes, sigurimi shoqëror i detyruar				
M	Arsimi	210	289	21,253	23,598
80	Arsimi	210	289	21,253	23,598
N	Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale	2,132	2,132	14,821	20,819
85	Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale	2,132	2,132	14,821	20,819
O	Aktivitete të tjera të shërbimit social dhe individual	78,012	69,860	330,851	350,812
90	Pastrimi, heqja e mbeturinave, trajtimi i hedhurinave dhe aktivitete të tjera të ngjashme	200	1,318	200	1,834
91	Aktivitete të organizatave të ndryshme shoqërore	70,792	59,397	59,039	71,982
92	Aktivitete dëfrimi, kulturore dhe sportive	6,756	8,965	271,433	276,646
93	Aktivitete të shërbimeve personale	266	180	180	351
P	Shërbime në shtëpi	0	0	0	0
95	Shërbime në shtëpi				
96	Aktivitete të prodhimit të mallrave të pandryshuar të familieve private për përdorimin e vet				
97	Aktivitete të prodhimit të shërbimeve të pandryshuara të familieve private për përdorimin e vet				
Q	Aktivitete të organizmave ndërkombëtarë	0	0	0	0
99	Aktivitete të organizmave ndërkombëtarë				
	Na	44,100	44,100	44,100	44,100
Total		15918472.668058	19,255,005	31210457.555887	37,708,160

SHËNIME

*Argita Frashëri: Përgjegjëse e Zyrës së Bilancit të Pagesave, Departamenti i Statistikës.

¹ Razin, A. : FDI flows, a critical look, NBER Reporter Spring 2002.

² UNITED NATION, World Investment Report, 1992.